



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 63**

**Datë: 24. 12. 2019. Ora: 13:30**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së**

**Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Sami Hamiti, Salih Morina, Adnan Rrustemi, Nazlije Bala, Stevan Veselinoviq, Ercan Spat, Alfred Kinolli, Čemailj Kurtiši.**

**SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Yll Buleshkaj, drejtor i ZRPPC**

**Përkthyes: Vera Dula. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.58,59,60,61 dhe 62/2019

**2. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

• **Këshilli për Çështje Ligjore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Fushë Kosovë dhe Podujevë

**3. Vlerësimi i Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së, dhe i Zëdhënësit të KQZ-së.**

**4. Të ndryshme.**

---

## **1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Krvesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.58,59,60,61 dhe, 62/2019*

**Valdete Daka:** E fillojmë mbledhjen. A kemi ndonjë vërejtje në rend dite...? Na kanë mbetur do objektiva të Tiranës, ndoshta përgatiten para vitit të ri...?

**Adnan Rrustemi:** Nuk e di se çka ka sjellë në mbledhje Këshilli për Buxhet dhe Financa, por unë nuk jam dakord me dy formulime nën pika të rendit të ditës. Mundemi t'i lëmë kështu dhe ti shqyrtojmë, por "shqyrtimi i kërkesave të KKZ-së për pagesat e KVV-së", mendoj që është e pa bazuar në mënyrën si është formuluar, madje edhe nuk na takon si KQZ me e shqyrtuar...! Nuk jam për ti shqyrtuar...!

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së shqyrtuan dhe miratuan procesverbalet nga mbledhjet e KQZ-së nr.58,59,60,61 dhe, 62/2019.

## **2.Raport i Këshillave të KQZ-së**

### **Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Fushë Kosovë dhe Podujevë:

**Salih Morina:** Këshilli, ka shqyrtuar dhe miratuar dy propozimet për zëvendësime: Pajtim Hudolli, emërohet anëtarë i Asamblesë Komunale të Podujevës nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm, Arbër Blakun, dhe z. Mensur Grajcevc, emërohet anëtarë i Asamblesë Komunale të Fushëkosovës nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm, Betim Ahmeti.

Anëtarët e KQZ-së, vec e vec, miratuan këto dy zëvendësime me dhjetë vota për...

**Valdete Daka:** A do ta shqyrtojmë çështjen e pagesës së KVV-ve...?

**Salih Morina:** Ne, këtë pikë e kemi shqyrtuar në takimin e këshillit ëpr çështje ligjore, dhe jemi dakorduar bashkërisht të gjithë që mos të marrim vendim, sepse një vendim ekziston. Kemi sqarim edhe nga zyra lidhore, dhe vërejtje ka pas..! Por, jemi akorduar që pagesat të bëhen, dhe se ne, e kemi një vendim para fillimit të fazës zgjedhore. Proceduralisht, është në rregull...Por, le ta diskutojmë së bashku...

**Adnan Rrustemi:** Nuk duhet të jetë buxhet shtesë, ose tejkalim për këto kategori ku, ishte dashur të involvohet KQZ ! Buxhetin e kemi, gjithashtu edhe vendimin dhe se, këtu kemi një vlerësim problematik: që të paguhen, duhet patjetër mbi bazën e punës, shërbimit, dhe nuk jemi në kohën e emërimit...Emërimi, ka ndodh...Nëse nuk i paguajmë, ne e shkelim ligjin...Tjetër, është çështja e verifikimit...! Mendoj që Sekretariati, po tenton me e bartë përgjegjësinë në KQZ: madje, edhe përgjegjësinë e emërimit, dhe jo vetëm të pagesave...! Pra, s'kemi paqartësi: nëse kanë qenë komisionarë, ata duhet të paguhen...! Mendoj që, meqë janë 400 komisionarë, për mua problematike është se, a është dashur të jenë ata, dhe

jo se a duhet të paguhen sepse, ata tashmë kanë realizuar shërbimet e tyre, dhe kanë qenë pjesë e procesit...

**Sami Hamiti**: Ne, kemi bërë shqyrtimin...si, a ka buxhet, dhe buxhet ka...! Një veprim ka ndodhur, kontratat janë bërë me ata njerëz nga Sekretariati...Pra, ka një marrëdhënie kontraktuale...Që ka shkelje procedurale, ka...! Por, nëse nuk paguhen, dëmi bëhet edhe më i madh...Ka edhe dëm përlllogaritës...! Ka, edhe manipulim të identitetit të personave, dhe ka raste edhe për prokurori...

**Nazlie Bala**: E kemi diskutuar gjatë, dhe kemi menduar se kjo kërkesë nuk ka pse të vijë në KQZ, sepse kemi një kërkesë që duhet vepruar drejtë. Nuk mund të sjellim vendim mbi vendim...! Ky, le të jetë një mësim për listën e KVV-e sepse, nuk ishte dashur të vijmë në situata të këtilla, pra njësia përkatëse herën tjetër le të jetë më e vëmendshme... Mendoj që Sekretariati, duhet të ketë shkallë më të lartë përgjegjësie ! Ne si KQZ, nuk mund të jemi “hije mbrojtëse”, “mbulesë” e Sekretariatit për gabimet që bëhen...

**Valdete Daka**: Unë po e shoh një rast ku një person, është në dy lista...! Bëhet fjala për një femër...

**Illir Gashi**: Si këshill, ne kemi konstatuar se nuk ka pengesa nga ana buxhetore. Por, ka një rekomandim nga zyra ligjore që të bëhet pagesa...! Edhe unë mendoj që, dëmi mund të jetë më i madh, nëse nuk paguhen por, ka lëshime të tjera... Ne, vetëm mund të pajtohemi që pagesat të ekzekutohen...

**Valdete Daka**: Si KQZ, ne nuk kemi pse të marrim vendim, kemi marrë njëherë...! Buxheti, është ndarë mbi vendimin tonë të marrë...

**Adnan Rrustemi**: Pavarësisht, unë shoh një situatë fragjile: ndërrohen komisionarët 24 orë para zgjedhjeve...!

**Valdete Daka**: Ne, vetëm konstatojmë që mjete ka dhe, ata duhet të paguhen...! Këtë pikë, në fakt, ne edhe po e eliminojmë nga rendi i ditës...

### **3.Vlerësimi i Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së, dhe i Zëdhënësit të KQZ-së**

**P.s.**

*Kjo pikë e rendit të ditës, është shlyrtuar me dyer të mbyllura....*

**4.Të ndryshme.**